



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) dhe në lidhje me nenin 21 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/2010, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21 dhe 74/24), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

V E N D I M **për depozita të disponueshme**

1. Me këtë vendim rregullohen kushtet dhe rregullat për përdorimin e depozitave të disponueshme në denarë (në tekstin e mëtejshëm: depozitet) te Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) si instrument i politikës monetare.

2. Të drejtë për vendosje të mjeteve në depozita në Bankën Popullore kanë bankat dhe filialet e bankave të huaja dhe kursimoret (në tekstin e mëtejshëm: pjesëmarrësi/pjesëmarrësit), të cilët i plotësojnë kriteret në vijim:

- kanë obligim të rezervës së detyrueshme te Banka Popullore dhe
- pjesëmarrës në Sistemin Pagesor Ndërbankar Maqedonas (në tekstin e mëtejshëm: SPNM).

3. Afatet e maturimit të depozitave janë një ditë pune (njëditore) dhe shtatë ditë, pa mundësi për tërheqje të parakohshme, të pjesërishme apo të plotë.

Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore vendos për lartësinë e normave të interesit të depozitave të disponueshme.

4. Vendosja e depozitave te Banka Popullore mund të bëhet në ditët e punës së SPNM-së, ku vendosja e depozitave njëditore është e disponueshme çdo ditë pune, ndërsa vendosja e depozitave për shtatë ditë është e disponueshme njëherë në javë.

Pjesëmarrësi e raporton Bankën Popullore për shumën që do ta vendosin në depozita të llogarisë së tyre, përmes SWIFT-it apo ndonjë mënyre tjetër të raportimit me shkrim.

5. Vendosja e mjeteve në depozita te Banka Popullore bëhet nëpërmjet paraqitjes së urdhëresës për transferim të mjeteve në llogari të veçantë në Bankën Popullore.

Pjesëmarrësi i paraqet urdhëresat për transferim të mjeteve në depozita te Banka Popullore deri në momentin kur SPNM-ja ndërpret pranimin e porosive për transferimin e mjeteve, nga pjesëmarrësit në SPNM për përdoruesit e tyre të shërbimeve të pagesave dhe ai është i parevokueshëm.

6. Banka Popullore i paguan depozitat në ditën e maturimit, me fillimin e orarit të punës së SPNM-së.

Interesi llogaritet dhe paguhet gjatë ditës së njëjtë të punës.

Interesi llogaritet me aplikimin e formulës më poshtë:

ku:

$$K = \frac{D \cdot k \cdot d}{100 \cdot 360}$$

K - interesi i depozitës;
D - shuma e depozitës;
k - norma e interesit;
d - numri kalendarik i ditëve.

7. Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore ka të drejtë ta kufizojë vendosjen e depozitave te Banka Popullore, pjesërisht ose tërësisht, për arsye të plotësimit të qëllimeve dhe udhëzimeve të politikës monetare.

8. Llogaritur deri në 1 qershor 2025, kursimoret mund të vendosin depozita te Banka Popullore, pavarësisht që nuk janë pjesëmarrës në SPNM.

9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi për depozita të disponueshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 263/22).

10. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02 - 40305/5
28 nëntor 2024
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
dr Anita Angellovska-Bezhoska

